



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

PROCESVERBAL ¹

(I përmbledhur)

Tiranë, më 15.02.2019, ora 10.00

Drejton mbledhjen

Ardian Dvorani – Kryetar i Këshillit

Rendi i Ditës :

1. Diskutimi dhe miratimi i Projektvendimit mbi Procedurën e Shortit të caktimit të relatorëve për pozicionet vakante në çdo institucion.

2. Diskutimi në parim i Projektvendimit për procedurat e verifikimit të kandidatëve për vendet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe për Inspektor i Lartë i Drejtësisë.

Marrin pjesë² :

- | | |
|--------------------------|------------------------|
| 1. Ardian Dvorani | (kryetar) |
| 2. Vitore Tusha | (zëvendës kryetare) |
| 3. Arta Marku | (anëtare) |
| 4. Fatri Islamaj | (anëtar) |
| 5. Margarita Buhali | (anëtare) |
| 6. Eriol Roshi | (anëtar) |
| 7. Medi Bici | (anëtar zëvendësues) |
| 8. Klodiana Veizi (Mema) | (anëtare zëvendësuese) |
| 9. Gurali Brahimllari | (anëtar zëvendësues) |

¹Për shkak të parashikimit shprehimisht në ligjin nr.115/2016 (neni 226 pika 1 shkronja "d", neni232 pika 2, neni 242 shkronja "c") dhe Rregullores së Brendshme të Funkcionimit të KED-së (neni 17), referuar pengesës ligjore për të bërë publike diskutimet e vetë anëtarëve të KED për çështjen e rendit të ditës, natyra përmbledhëse e procesverbalit, imponon që edhe diskutimet e Avokatit të Popullit dhe subjekteve të ftuara të pasqyrohen në mënyrë të përmbledhur. KED, disponon materialin e plotë audio dhe te zbardhur me shkrim të çdo mbledhje, sipas ligjit.

²Anëtarja e Fatjona Memçaj nuk merr pjesë në diskutimin dhe miratimin e akteve nënligjore normative, për shkak të papajtueshmërisë-marrëdhënie krushqie e afërt me kandidaten Ardita Alsula. Sipas ligjit, Kryetari i Këshillit e ka miratuar heqjen dorë me vendimin nr.1 datë 14.02.2019.

Merr pjesë, si vëzhguese e përhershme :

1. Erinda Ballanca, Avokate e Popullit.

Marrin pjesë, si të ftuar, përfaqësues nga subjektet e treguar në nenin 233/2 të ligjit nr. 115/2016 :

1. Bledar Dervishaj, përfaqësues i Presidentit të Republikës.
2. Genci Gjonçaj, përfaqësues i kryetarit të Kuvendit.

Marrin pjesë, si të ftuar, përfaqësues nga institucionet ndërkombëtare, mbështetëse të procesit të hartimit të akteve nënligjore të KED :

1. Anita Mihailova, eksperte e EURALIUS
2. Klodian Rado, ekspert i EURALIUS
3. Maniela Sota, Koço Bendo, përkthyes për EURALIUS

HAPET MBLEDHJA

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani, deklaron të hapur mbledhjen.

Verifikohet prania dhe pjesëmarrja e anëtarëve të Këshillit.

Informohet Këshilli për heqjen dorë të anëtares Fatjona Memçaj nga pjesëmarrja në diskutimin dhe miratimin e akteve nënligjore normative, për shkak të papajtueshmërisë-marrëdhënie krushqie e afërt me kandidaten Ardita Alsula. Sipas ligjit, Kryetari i Këshillit e ka miratuar heqjen dorë me vendimin nr.1 datë 14.02.2019.

Ardian Dvorani lexon çështjet e rendit të ditës të njoftuar paraprakisht:

1. Diskutimi dhe miratimi i Projektvendimit mbi Procedurën e Shortit të caktimit të relatorëve për pozicionet vakante në çdo institucion.

2. Diskutimi në parim i Projektvendimit për procedurat e verifikimit të kandidatëve për vendet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe për Inspektor i Lartë i Drejtësisë.

Shtrohet për diskutim miratimi i rendit të ditës së paraqitur për këtë mbledhje të Këshillit.

Anëtarët e Këshillit miratojnë pa ndryshime dhe shtesa të tjera rendin e ditës.

Këshilli fillon diskutimin lidhur me dispozitat e projektaktit normativ “Për procedurën e shortit të caktimit të relatorëve për pozicionet vakante në çdo institucion”.

Ardian Dvorani paraqet qëllimin e projektaktit, strukturën dhe përmbajtjen në tërësi të dispozitave të këtij projektakti.

Anëtarët e Këshillit dhe pjesëmarrësit e tjerë diskutojnë përmbajtjen e pjesës hyrëse dhe dispozitave të Kreut I të projektakti sipas përcaktimeve të nenit 228 të ligjit nr.115/2016.

Anëtarët e Këshillit miratojnë me shtesa dhe ndryshime dispozitat e këtij Kreu.

Anëtarët e Këshillit dhe pjesëmarrësit e tjerë diskutojnë përmbajtjen e dispozitave të Kreut II “Përgatitja dhe njoftimet për procedurën e caktimit të relatorëve përmes shortit elektronik”.

Anëtarët e Këshillit miratojnë me shtesa dhe ndryshime dispozitat e këtij Kreu.

Anëtarët e Këshillit dhe pjesëmarrësit e tjerë diskutojnë përmbajtjen e dispozitave të Kreut “Caktimi i relatorëve përmes shortit elektronik” dhe Kreut “Procedura për caktimin e relatorëve përmes shortit manual”.

Erinda Ballanca, në diskutimet e saj, kërkon fjalën dhe parashtron se në kuptim të drejtë të ligjit, pra edhe teorikisht, të gjithë anëtarët e Këshillit do të përfshihen kur të hidhet shorti për relatorin. Sipas ligjit shorti kërkon që për një organ emërtese të ketë një relator. Por shtrohen për zgjidhje pyetjet se çfarë do të ndodhë tani në kushtet e më shumë së një vakance për çdo organ emërtese, nëse në shortin e dytë do të jenë përsëri të gjithë anëtarët apo ai që u zgjodh relator i parë nuk do të përfshihet më, si do të veprohet në rastin kur anëtari relator i zgjedhur me short përjashtohet nga shqyrtimi i njëres kandidaturë për shkak të rasteve që parashikon ligji dhe ae mund të caktohet vetëm për këtë kandidat një relator tjetër.

Një çështje që shtohet për diskutim ka të bëjë me faktin se ky Këshill do të vihet përpara procedurave të përzgjedhjes për 9 vende vakante njëkohësisht, çka është një rast që nuk është parashikuar nga ligji. Ndërkohë ky Këshill nuk mund të bëjë një rregull për përjashtimin, rregulli duhet parashikohet për të gjitha rastet. Në të gjitha rastet nuk e gjejnë të arsyeshme që personin e kandiduar në vakanca të ndryshme ta verifikojë dhe vlerësojë i njëjti anëtar i Këshillit, apo këto veprime të bëhen vetëm njëherë sepse teorikisht mund të ndodhë që ka diferencë kohe midis shpalljes së një vakance dhe shpalljes së një vakance tjetër. Ndërkohë kandidati mund të kenë bërë më shumë veprime juridike, mund të kenë marrë më shumë dokumentacion, mund të jetë ndriçuar në një fushë të caktuar për të cilin Këshilli më parë nuk e renditi në vendet e para. Prandaj, në të gjitha rastet, qoftë verifikimi, qoftë vlerësimi, duhet të bëhet nga relatori për kandidatët sipas secilit pozicion vakant ku është kandiduar sepse ligji është i qartë kur tregon relatorin në pozicionet vakante për çdo institucion dhe nuk thotë për pozicionin vakant për çdo institucion. Nuk mund të rregullohet ndryshe me akt nënligjor.

Bledar Dervishaj, në diskutimet e tij kërkon fjalën dhe parashtron se ndoshta do të duket ndërhyrje e lehtë, por duhet parë me vëmendje pika 1 e nenit 228 për shkak se parashikon që, për renditjen e kandidatëve, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi cakton me short një relator për

pozicionet vakante në çdo institucion. Lind pyetja a do të kemi një relator për tre vakanca të çdo institucioni? Apo një relator për secilën vakancë të atij institucioni?

Për radhën e shortimit mund të mbahet parasysh që vendet vakante nuk është se janë shpallur njëkohësisht dhe as kanë ardhur pranë Këshillit njëkohësisht. Ato janë shpallur dhe kanë ardhur në kohë të ndryshme. Prandaj edhe hedhja në short të bëhet sipas kohës kur janë shpallur nga organet e emërtesës.

Nesë ju do të vendosni relator për secilën vakancë dhe shqyrtimi i vlefshmërisë për lejimin e kandidimit do të bëhet i njëkohshëm nga të dy relatorët, kur ata të relatojnë në mbledhje mund të ndodhë që ata e shikojnë ndryshe, lejimin ose ndalimin e kandidaturës, por megjithatë është Këshilli që merr një vendim për të dyja rastet. Sepse janë dy vakanca të ndryshme. Kjo lidhet edhe më një rast tjetër, rastit kur ka më shumë se një vakancë dhe sipas ligjit hartohen dy lista nga Këshilli. Njëra me gjyqtarë dhe një tjetër pa gjyqtarë. Këtë do të kenë parasysh edhe relatorët e vakancave përkatëse. Kjo është një situatë shumë komplekse dhe duhet treguar kujdes maksimal. Kandidati ka të drejtën që të kërkojë procedurën e verifikimit nga secili anëtar i Këshillit që është shortuar si relator i secilit vend vakant.

Anita Mihailova (përkthen përkthyesja), kërkon fjalën dhe parashtrohet që nëse relatori ka një konflikt interesi me një nga kandidatët, këtë konflikt e ka me të gjithë listën për shkak se kjo pastaj do të reflektohet me pikëzimin, me sistemin e vlerësimit. Është dhe një pjesë tjetër që është e lidhur me këtë pikë, tek pika 19, pjesa ku thotë ai zëvendësohet automatikisht nga anëtari zëvendësues sipas ligjit. Një zgjidhje mund të jetë që anëtari në konflikt interesi zëvendësohet automatikisht nga anëtari zëvendësues. Ligji flet për një relator për të referuar për pozicionin vakant. Qëllimi i legjislatorit ishte që vetëm një anëtar i Këshillit të merret me të gjithë kandidatët që kanë aplikuar për atë pozicion e në mënyrë që më pastaj të bëhet renditja e tyre.

Lidhur çështjet e diskutuara për verifikimin dhe vlerësimin e njëkohshëm të kandidaturave të kandidatëve në më shumë se një vend vakant, ndoshta mund ti shtroni për diskutim dhe ti jepni një zgjidhje tek rregullat që kanë të bëjnë me verifikimin dhe vlerësimin e kandidatëve, por jo në këtë akt për shortin.

Anëtarët e Këshillit, në përfundim të diskutimeve dhe qëndrimeve të dakordësuara, duke reflektuar edhe mendimet e qëndrimet e parashtruara nga ana e pjesëmarrësve në mbledhje, e miratojnë me ndryshime dhe riformulime përmbajtjen e dispozitave të Kreut III “Caktimi i relatorëve përmes shortit elektronik” dhe Kreu IV “Procedura për caktimin e relatorëve përmes shortit manual”

Anëtarët e Këshillit dhe pjesëmarrësit e tjerë diskutojnë përmbajtjen e dispozitave të Kreut “Procedura për caktimin përmes shortit të ndihmësve ligjorë”.

Anëtarët e Këshillit, në përfundim të diskutimeve dhe qëndrimeve të dakordësuara, duke reflektuar edhe mendimet e qëndrimet e parashtruara nga ana e pjesëmarrësve në mbledhje, e miratojnë me ndryshime dhe riformulime përmbajtjen e këtij Kreu.

Anëtarët e Këshillit dhe pjesëmarrësit e tjerë diskutojnë përmbajtjen e dispozitave të Kreut “Dispozita kalimtare dhe të fundit”.

Anëtarët e Këshillit, në përfundim të diskutimeve dhe qëndrimeve të dakordësuara, duke reflektuar edhe mendimet e qëndrimet e parashtruara nga ana e pjesëmarrësve në mbledhje, e miratojnë me ndryshime dhe riformulime përmbajtjen e dispozitave të këtij Kreu.

Në përfundim të diskutimeve, shqyrtimit dhe miratimit nen për nen, *anëtarët e Këshillit votuan unanimit për miratimin në tërësi të aktit normativ, vendimit “Për procedurën e shortit të caktimit të relatorëve për pozicionet vakante në çdo institucion”*.

Anëtarët e Këshillit vendosën që të shtyhet diskutimi mbi pikën e dytë të rendit të ditës lidhur me projektvendimin për procedurat e verifikimit të kandidatëve për vendet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe për Inspektor i Lartë i Drejtësisë, në kushtet kur nevojitet më shumë kohë për përgatitjen e materialit për shqyrtim në mbledhje dhe për bashkërendimin e punës me Euralius për këtë qëllim.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani duke shpallur zhvillimin e mbledhjes së radhës në datën 22.02.2019, ora 10.00, me rend dite diskutimi dhe miratimi i projektvendimit për procedurat e verifikimit të kandidatëve për vendet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe për Inspektor i Lartë i Drejtësisë, deklaroi mbylljen e mbledhjes.

MBLEDHJA MBYLLET ME ORËN 12.42.

Sekretare

Redjona MYRTJA

Ermelinda KADIU

Kryetari

Ardian DVORANI

Shënim: Diskutimet e zhvilluara në gjuhën angleze, janë reflektuar të përkthyer në këtë procesverbal. Përkthimi është kryer nga personel i vetë institucioneve të ftuar.